



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljevu / Predato Received / Delivered	31.05.2021	viti god year	1
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHOK	2739/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.293/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.293/2021 të datës 21.04.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr.“Eduard Lir”, Nr.72, Dragodan/Prishtinë, kundër masës disiplinore “Vërejte” të datës 19.04.2021 të shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Drejtorisë për Administrimin e Monumenteve Natyrore më Rëndësi të Veçanta në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, në çështjen juridike “masës disiplinore-vërejtje me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 31.05.2021, mori këtë

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.293/2021 e datës 21.04.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore “Vërejte” e datës 19.04.2021 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Drejtorisë për Administrimin e Monumenteve Natyrore më Rëndësi të Veçanta në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, me datë 21.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1917/2021 të regjistruar me numër A.nr.293/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se masa disiplinore “Vërejte” e datës 19.04.2021 e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Drejtorisë për Administrimin e Monumenteve Natyrore më Rëndësi të

Veçanta në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Këshilli më datë 29.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.04.2021 me Nr.Prot:1917/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 08.04.2021 nga L. E-mailin e datës 07.04.2021 nga ankuesja; Vërejtjen e datës 19.04.2021 e shqiptuar ndaj ankueses; Njoftimin e datës 07.04.2021 nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të Emërimit i datës 04.10.2019 për ankuesen; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankueses datës 02.04.2019; E-mailin e datës 29.03.2021 nga E-mailin e datës 23.02.2021, 18.02.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 16.02.2021 nga dhe A E-mailin e datës 18.02.2021 nga A dhe ankuesja; Fotografitë e veturës; Deklaratë për KPMSHCK nga Drejtori Ekzekutiv i AMMK-së e datës 28.04.2021; Fotografitë e datës 14.04.2021; E-mailin e datës 08.04.2021 nga E-mailin e datës 07.04.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 24.03.2021 nga E-mailin e datës 24.03.2021 dhe 06.04.2021 nga E-maili i datës 06.04.2021 nga E-mailin e datës 12.04.2021 nga E-mailin e datës 12.04.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 21.02.2020 nga E-mailin e datës 19.03.2021 nga E-mailin e datës 28.04.2021 nga Vendimin me Nr.01/05 i datës 05.04.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 25/AMMK/2021 i datës 06.04.2021 i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Bazuar ne shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit të datës 04.10.2019 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit për Monumente me Rendësi të Veçanta në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Drejtorisë për Administrimin e Monumenteve Natyrore me Rëndësi të Veçantë, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 19.04.2021, ankueses i ka shqiptuar masë disiplinor "Vërejtje me shkrim" me arsyetimin se: ...më datë 14.04.2021 ka lejuar hyrje e vizitorëve në MNRV "Shpella e Gadimes", edhe përkundër faktit se nga data 12-18 prill 2021, vizitat në shpellë kanë qenë të pezulluara, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.01/05, të datës 05.04.2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta, për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e COVID-19, si dhe Vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të AMMK-s, me Nr.25/AMMK/2021 të datës 06.04.2021; po ashtu nuk ka njoftuar deri më tani për problemin që qëndron me funksionimin e kamerave të sigurisë në zyrat e MNRV "Shpella e Gadimes"; Edhe përkundër faktit që në cilësinë e mbikëqyrësit të

drejtpërdrejtë më datë 24.03.2011, përmes E-mailit zyrtarë i kam kërkuar që në çdo komunikim zyrtar të më lidhë në CC, ka vepruar të kundërtën duke mos me përfshirë në disa komunikime zyrtare; Me qasjen që ka nëpunësja në vendin e punës, ka krijuar marrëdhënie të tensionuara brenda stafit të MNRV "Shpella e Gadimes", Menaxheri i transportit në MMPHI, dy herë radhazi më datë 16.02.2021 dhe 06.04.2021 përmes E-mailit zyrtar, i ka parashtruar kërkesa znj. për të sjell raportin e dëmeve të veturës zyrtare, por deri tani nuk e ka sjell këtë raport. Pas kësaj, unë si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë më datë 06.04.2021, kam kërkuar nga nëpunësja që ti drejtohet Policisë së Kosovës më një shkresë zyrtare me qëllim të sigurohet raporti për dëmet e veturës, por e njëjta nuk e ka parashtruar një kërkesë të tillë".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka konstatuar se bazuar në Vendimin me Nr. 01/05 të datës 05.04.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, më datë 06.04.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.25/AMMK/2021 për caktimin e stafit esencial, ndërsa në bazë të njoftimit të datës 07.04.2021 janë pezulluar vizitat në Monumentin me Rendësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" nga data 07.04.2021 deri më datë 18.04.2021, me çka ka qenë e njoftuar edhe ankuesja e cila në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pohuar që ka qenë e njoftuar por thekson se vizitat janë pezulluar me një njoftim të shkurtër dhe të paqartë.

Bazuar në provat e administruara, respektivisht në bazë të fotografive të datës 14.04.2021 shihet që disa persona janë duke u futur brenda Monumentit me Rendësi të Veçantë "Shpella e Gadimes", këtë e ka pohuar edhe ankuesja në ankesë e saj. Andaj, bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja si Udhëheqëse e Sektorit për Monumentin me Rendësi të Veçanta, nuk ka respektuar vendimet e institucioneve respektivisht njoftimin e datës 07.04.2021 të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, por ka lejuar që vizitorët të bëjnë vizita në Monumentit me Rendësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" edhe pse vizitat kanë qenë te pezulluara për periudhën nga data 07.04.2021 deri më datë 18.04.2021, me këtë rast ankuesja me veprimet e saj ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Shkelje të lehta konsiderohen: kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", kështu që pretendimet e ankueses janë të paqëndrueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se si udhëheqës i drejtpërdrejt i ankueses përmes e-mailit zyrtar më datë 24.03.2021 ka kërkuar nga ankuesja se "për çdo komunikim zyrtar që e realizoni të çfarëdo natyre, patjetër të vendose në cc edhe Drejtori i DAMNRV", mirëpo ankuesja në komunikimin përmes e-mailit të datës 07.04.2021 që ka pasuar me z. nuk ka vendosur cc udhëheqësin e saj të drejtpërdrejtë duke bërë anashkalimin e udhëheqësit të saj të drejtpërdrejt, me çka ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet e ankueses janë të pa bazuara.

Bazuar në e-mailin e datës 29.03.2021 mes nëpunëses civile dhe ankueses, e njëjta akuzon ankuesen se nuk ka sjellje korrekte ndaj vizitorëve duke mos i pajisur me bileta adekuate,

ndërsa ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, edhe pse ka theksuar që do të argumentoj të kundërtën nuk ka sjell asnjë provë me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet e nëpunëses

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës ka gjetur se Menaxheri i Transportit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes e-mailit më datë 16.02.2021 ka njoftuar Kryeshëfin Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës se për veturën e dëmtuar (gërvishur dhe shtypur) nuk është lajmëruar asgjë, sepse përgjegjësia i bie ngasësit, ndërsa Kryeshëfi Ekzekutiv i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës përmes e-mailit të datës 16.02.2021 ka kërkuar nga ankuesja që urgjentisht të përgatitet dokumentacioni i duhur lidhur me rastin e paraqitur nga menaxheri i transportit, ndërsa ankuesja më datë 18.02.2021 ka njoftuar që vetura ka pasur vetëm grithje të cilat i janë bërë në parking gjatë vikendit,...por nuk kemi arritur ti lajmërojmë pasi puna është duke u zhvilluar me staf esencial. Bazuar në këto rrethana dhe në bazë të provave të lëndës respektivisht komunikimit të datës 18.02.2021 ankuesja nuk ka raportuar gërvishtjen apo dëmtimin e veturës, siç kërkohet me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës. Po ashtu në bazë të provave të lëndës udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses më datë 06.04.2021 përmes e-mailit ka kërkuar nga ankuesja të parashtrohet sa më parë një kërkesë zyrtare në Stacionin Policor në Lipjan duke kërkuar raportin për këtë rast, mirëpo nuk ka asnjë dëshmi që pas kësaj ankuesja të këtë marrë veprime për rastin në fjalë, andaj pretendimi i ankueses është i paqëndrueshëm.

Duke u bazuar në të lartcekurat, dhe duke marr parasysh të gjitha veprimet që ankuesja ka bërë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që ankuesja me veprimet e saj ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesja nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit siç parashihet me nenin 25 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: 2. *Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.* 3. *Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike",* po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, *zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij.*

Në bazë të këtyre, meqenëse ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesja, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësit disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit,* mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e

Ankesave, konstaton se masa disiplinore "vërejtje" e shqiptuar ndaj ankueses, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", nenin 13 paragrafin 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, po ashtu duke marr parasysh që ndaj ankueses përmes e-mailit gjatë vitit 2020 dhe vitit 2021 respektivisht më datë 12.04.2021 dhe 21.02.2020 janë shqiptuar dy vërejtje.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.293/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe;
- Arkivot të KPMSHCK-së.

